

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ELBESA 2023 ” SH.P.K

Ne baze te **Ligjit Nr.9723** , date 03.05.2007”Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit” dhe **Ligjit Nr.9901**, date 14.04.2008 , per “Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare “, dhe akteve te tjera ligjore e nenligjore ne fuqi , Kerkuesi : Z. Besnik Pisha themelues i shoqerise :

“ELBESA 2023”SH.P.K me seli qendrore ne Elbasan, Prrenjas, Qukes Skroske me zone kadastrale, 3468 nr pasurie 516/7.

me administrator Z. Besnik Pisha i datelindjes **20.02.1980** mbajtes i kartes se indentitetit me nr. **I00220199C**

FORMIMI

Neni 1

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar me emertimin **“ELBESA 2023” SH.P.K** formohet nga ortaku i vetem Z. Besnik Pisha, Administratori i kesaj shoqerie do te jete Z.Besnik Pisha me nje periudhe prej 5(pese) vjetesh me te drejte rizgjedhje.

VENDQENDRIMI

Neni 2

Selia qendrore ne Elbasan, Prrenjas, Qukes Skroske me zone kadastrale, 3468 nr pasurie 516/7.

KOHEZGJATJA

Neni 3

Kohezgjatja e aktivitetit te Shoqerise do te jete per nje afat te pacaktuar dhe mund te shperbehet ne cdo kohe. Shoqeria mund te ndryshoje emrin , seline,si edhe objektin e sajje sipas vendimit te ortakut te shoqerise.



Neni 4

Veprimtaria e shoqerise do te zhvillohet ne perputhje te plote me dispozitat e ketije Akt Themelimi dhe Statutit, dhe mbeshtetur ne legjislacionin shqiptar ne fuqi , akteve ligjore e nenligjore qe rregullojne aktivitetin dhe funksionimin e shoqerise tregtare

Neni 5

Shoqeria vepron ne regjimin e prones dhe merr vet persiper te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe ka.

Ajo pergjigjet vet per detyrimet e sajë kontraktore e jashtkontraktore Brenda kapitalit qe ka .

Ortaku i shoqerise bart rrezikun e veprimtarise se shoqerise Brenda kapitalit te sajë.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 6

Aktivitetin e sajë shoqerija do ta zhvilloje ne fushen e :

Shfrytezim te minierave dhe karrierave te punimve siperfaqesore dhe nentokesore. Import – Eksport i mineraleve, pllakave gureve dekorative, pajisjeve dhe makinerive.

Megjithate Shoqeria ka te drejte te marre persiper edhe ativitete te tjera , te shtoje aktivitetin e sajë , te hape filjale e dege ne te gjithë territorin e Republikës se Shqiperise .

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 7

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte **100.000 leke** (Njeqindeminje) lek i cili perben 1 kuote i formuar teresisht nga ortaku Z. Besnik Pisha 100% te aksioneve me vlere nominale 100000



Neni 8

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te paksohet sipas vendimit qe do te marri ortakut i shoqerise Z. Besnik Pisha. Aktiviteti ne kete Shoqeri nuk pengon ortakun te kete te drejta pronesie jashte Shqiperise ,qofte si juridik apo cfare do forme tjeter ligjore . Shoqerija nuk pergjigjet per detyrimet e ortakut te shoqerise jashte shoqerise.

Neni 9

Shoqeria eshte pergjegjese vetem per kapitalin e mjetet qe disponon dhe asgje me teper.

Shoqeria deklarohet e krijuar me regjistrimin e sajve ne Zyren e Rregjistrimit Tregtare ne Qendren Kombetare Te Biznesit.Me regjistrimin e sajve ne Organin Kopetent, Shoqeria fiton zotesine e sajve juridike, ndersa nga aktiviteti fillon pas regjistrimit ne Zyren e Taksa-Tatimeve perkatese.

Neni 10

Shoqeria ka vulen e sajve, permbajtja e seciles eshte e njejte me emertimin e sajve.

Neni 11

Per sa nuk eshte trajtuar ne kete akt-themelim , i referohet plotsimeve qe behen nga ortakut i shoqerise Z. Besnik Pisha, nepermjet vendimeve qe merren prej tije si dhe ne referim te ligjit Nr.9901 , date 14.04.2008” per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”

Neni 12

Dispozita te hollsishme mbi organizimin e shoqerise percaktohen ne **STATUTIN** e sajve.

Neni 13

Ky akt-themelim u redaktua ne pese kopje origjinale, nje nga te cilat depozitohet ne Zyren e Tatim Taksave , kopje e tjera mbahen ne dokumentacionin e Shoqerise “**ELBESA 2023 “ SH.P.K .**

Librazhd me 23. 10 .2023

ORTAKU I SHOQERISE

Besnik Pisha

